

RAPORT I HULUMTIMIT

PËR NEVOJAT E GJENDJES PSIKO-SOCIALE DHE EMOCIONALE
TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E FERIZAJT

Ferizaj, 2017



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



CARITAS
KOSOVA

RAPORT I HULUMTIMIT

**PËR NEVOJAT E GJENDJES PSIKO-SOCIALE DHE EMOCIONALE
TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E FERIZAJT**

Ferizaj 2017

Botues:	CARITAS KOSOVA Rr. Shën Nënë Tereza 70000 Ferizaj Republika e Kosovës
Përgjegjës:	Don Viktor Sopi Drejtor gjeneral
Koordinator i projektit:	Jakup Sabedini
Menaxher i projektit:	Albion Murseli
Projekti:	Bashkarisht per te drejtat e personave me aftesi te kufizuar
Monitoruesë	Grupi komunal punues për të drejtat sociale të grupeve vulnerabël në Ferizaj: Vjollca Krasniqi , udhëheqëse e njësisë për të drejtat e njeriut; Ibrahim Musliu , udhëheqës i sektorit për mirëqenie sociale (MSHMS); Afrim Llabjani , zyrtar i arsimit parafillor dhe fillor (DKA); Dashurije Ahmeti , udhëheqëse e sektorit të rinisë (DKRS); Mehmet Jashari , zyrtar i zyrës për komunitete dhe kthim.
Projekti:	Bashkërisht për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar (SEKTORI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM)
Përpunimi i të dhënave:	Dr. Fitim Uka , (Qendra për hulumtime psiko-sociale dhe mjekësore)
Dizajn:	Nikolin S. Sopi

Mbrojtja e të drejtave sociale të personave me aftësi të kufizuar

Respektimi i dinjitetit njerëzor, promovimi i lirisë dhe prosperitetit njerëzor në forma të ndryshme, përkrahja e personave të marginalizuar, janë vlera që ngërthen vetë misioni i Caritas Kosova . Në realizimin e këtij misioni, Caritas Kosova implementon programe dhe projekte të ndryshme edhe në fushën e të drejtave sociale, në bashkëpunim me institucione të tjera.

Një ndër to është edhe Projekti rajonal mbi të drejtat sociale për grupet e cënueshme, projekt ky i mbështetur nga organizata gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ), në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Në kuadër të këtij projekti Komuna e Ferizajt dhe Caritas Kosova kanë implementuar projektin Bashkërisht për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim që kjo kategori të jetë identifikuar, mbështetur dhe riintegruar, nëpërmjet objektivave më specifike, që institucionet lokale të kenë rritur kapacitetin për identifikimin dhe rritjen e vetëdijesimit shoqëror.

Një ndër aktivitetet e projektit në fjalë ka qenë edhe ky hulumtim që të identifikohen nevojat konkrete, si dhe gjendja psiko-sociale dhe emocionale e personave me aftësi të kufizuar në komunën e Ferizajt.

Për kontributin e dhënë në realizimin e këtij hulumtimi, Caritas Kosova falënderon institucionet dhe organizatat joqeveritare në komunën e Ferizajt: Qendrën për Punë Sociale, Hendifer, Handicap Kosova, Shoqatën e të Verbërve, Handikos, Down Syndrom Kosova, OJQ PEMA. Veçanërisht falënderon Qendrën për hulumtime psiko-sociale dhe mjekësore në Prishtinë për përpunimin e të dhënave nga anketimi dhe nxjerrjen e këtij raporti të hulumtimit.

Besojmë se ky hulumtim do të shërbejë si bazë për hartimin e aktiviteteve dhe fushatave të ardhshme, si dhe në çështjet në të cilat duhet fokusuar institucionet dhe akterët relevantë. Ky angazhim paraqet punën e vazhdueshme të Caritas Kosova, sipas planit strategjik (2013 – 2017) në mbështetjen e mbrojtjes së të drejtave sociale për grupet e cënueshme e posaçërisht në rritjen e e vetëdijesimit të shoqërisë, është cilësuar një ndër prioritetet kryesore.

**Don Viktor Sopi, drejtor gjeneral
Caritas Kosova**

¹ **Plani Strategjik (2013-2017) i Caritas Kosova.** Misioni – Caritas Kosova, si institucion bamirësie në Kosovë, analizon nevojat e njerëzve dhe komuniteteve kosovare dhe në përputhje me këto nevoja promovon lëvizje, iniciativa, duke zhvilluar programe dhe projekte për të përmirësuar cilësinë e jetës, për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë ndërtimin e paqes, arsimin dhe kujdesin ndaj njerëzve në nevojë dhe të marginalizuar. www.caritaskosova.org

Përmbajtja

Përmbajtja	7
Rezultatet	15
Gjendja shëndetësore e personave me aftësi të kufizuar	15
Natyra e nevojave të personave me aftësi të kufizuar	16
Mundësia e qasjes në institucione	18
Mbështetja nga ana familjare dhe shoqërore për personat me aftësi të kufizuar	20
Qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj personave me aftësi të kufizuar	24
Niveli i arsimimit tek personat me aftësi të kufizuar	26
Shkalla e punësimit tek personat me aftësi të kufizuar	28
Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar	30
Përfundime me bllok fakte	38
Rekomandimet	39

Hyrje

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë pjesë e rëndësishme e secilës shoqëri. Ata kanë nevojë për dashuri, mbështetje dhe motivim.

Sidoqoftë, anembanë botës personat me aftësi të kufizuar, jo rrallë janë edhe subjekte të paragjykitimit dhe diskriminimit. Përkundër faktit që ka një numër të madh të kampanjave sensibilizuese, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë vështirësi në ballafaqimin e sfidave të përditshme jetësore dhe së këndejmi edhe gjendja e tyre psiko-sociale dhe emocionale është më e rënduar.

Vendet e ndryshme të botës, në praktikën e tyre më të mira, synojnë që fillimisht të realizojnë analizën e nevojave që kanë personat me aftësi të kufizuar dhe më pas edhe hartimin e strategjive efektive për intervenim.

Sidoqoftë, një gjë e tillë ka munguar në Kosovë.

Shumica e projekteveintervenuese, nuk kanë marrë për bazë nevojat e popullatës target, dhe së këndejmi, nuk kanë adresuar fare shqetësimet e tyre.

Qëllimi i hulumtimit

- 1.Gjendja shëndetësore;
- 2.Natyra e nevojave;
- 3.Mundësia e qasjes së tyre në institucione;
- 4.Mbështetja nga ana familjare dhe shoqërore;
- 5.Qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj tyre;
- 6.Niveli i arsimimit;
- 7.Shkalla e punësimit dhe
- 8.Gjendja emocionale e tyre.

Metodologjia

Mostra dhe të dhënat demografike

Hulumtimi i realizuar nga Caritas Kosova në mostër përfshin 143 respondentë. Duke pasur parasysh madhësinë dhe strukturën e popullatës që studiohet, një mostër e tillë konsiderohet të jetë reprezentative.

Mosha mesatare e pjesëmarrësve të përfshirë në studim është 39.68 vjeç, ku pjesëmarrësi më i ri i takon moshës 6 - vjeçare dhe më i vjetri moshës 92- vjeçare. Mosha që më së shumti është prezantuar në këtë mostër është 27 vjeç (4.9 %) duke vazhduar më pas me moshën 17- vjeçare (4.2 %) dhe mosha 35 - vjeçare (3.5 %). Ndërsa, sa i përket proporcionit gjinor, 52.4% të të anketuarve i takojnë gjinisë femërore dhe 47.6 % të gjinisë mashkullore.




Fig. 1.0. Proporcioni gjinor në mostrën e përzgjedhur

Sa i përket nivelit të edukimit, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë të përfunduar shkollimin fillor (40.6 %), e pasuar nga 16.8 % me shkollimin të mesëm dhe vetëm 3.5 % e kanë të përfunduar shkollimin universitar. Ndërkaq, nga mostra e përzgjedhur, 39.2 % nuk kanë raportuar për nivelin e tyre të shkollimit.

Në tabelë 1.1. mund të shihen vendbanimet e të anketuarve të cilët ishin nga komuna e Ferizajt:

Vendi	Frekuenca	Përqindja
Balaj	6	4.2 %
Bibaj	7	4.9 %
Cernillë	4	2.8 %
Doganaj	1	.7 %
Dremjak	9	6.3 %
Ferizaj	12	8.4 %
Gaçkë	7	4.9 %
Gerlicë	2	1.4 %
Gremë	11	7.7 %
Komogllavë	13	9.1 %
Koshare	6	4.2 %
Kosinë	2	1.4 %
Lloshkobarë	7	4.9 %
Manastirc	4	2.8 %
Prelez i Muhaxherëve	7	9.1 %
Slivovë	8	5.6 %
Softaj	3	2.1 %
Sojevë	7	4.9 %
Surqinë	4	2.8 %
Ternn	5	3.5 %
Varosh	7	4.9 %
Zllatar	4	2.8 %

Tabela 1.1. Vendbanimi i të anketuarve

Nga subjektet pjesëmarrëse në hulumtim, pjesa më e madhe e tyre nuk kanë ndonjë profesion (11.9 %), ndërsa rreth 7.7 % e femrave në mostër janë me profesion amvise. Një pjesë tjetër e mostrës prej 6.1 % janë studentë, 2.1 % janë bujq dhe profesione të tjera në përqindje më të vogla, të cilat mund të shihen në fig. 1.2.




Fig. 1.2. Profesioni

Shumica e subjekteve të këtij hulumtimi (49 %) posedojnë një status mesatar sa i përket gjendjes ekonomike familjare. Ndërkaq, 46.2 % kanë një status të dobët ekonomik në familje, ndërsa status të mirë ekonomik posedojnë vetëm 1.4 % e të anketuarve. Një prezantim grafik të këtyre të dhënave mund të shihni në figurën 2.0.




Fig. 2.0. Statusi ekonomik familjar i personave me aftësi të kufizuar

Gjithashtu subjektet e këtij hulumtimi janë pyetur edhe për statusin e tyre martesor. Sipas rezultateve, një përqindje e madhe prej 61.5 % nuk janë të martuar dhe 38.5 % janë të martuar. Nga 38.5% e të anketuarve të cilët kanë një status martesor 32.9 % e tyre kanë fëmijë ndërsa pjesa tjetër, pra rreth 65.7 % nuk kanë fëmijë. Fig.2.1.




Fig. 2.1. Statusi martesor dhe fëmijët

Për të përmbyllur sesionin e pyetjeve demografike, të anketuarit janë pyetur edhe për numrin e antarëve të familjes. Kështu, pjesa më e madhe e të anketuarve jetojnë në familje 5 deri në 7 anëtarëshe (53.9 %), duke vazhduar me 23.1 % të cilët jetojnë në një familje prej 2 - 4 anëtarëshe.

Gjithashtu kishte edhe të atillë që jetonin në një familje prej 8 deri në 10 anëtarshë (14 %). Mirëpo vetëm 8.4 % jetojnë në familje me nga 11 deri në 15 anëtarë. Të gjitha këto janë të pasqyruara në grafikonin në fig. 3.0.




Fig. 3.0. Numri i antarëve në një familje

Të gjitha këto pyetje, kanë ofruar mundësinë e grumbullimit të të dhënave demografike, të rëndësishme për analizën e rezultateve të këtij hulumtimi. Në analizat konkluduese, disa nga këto të dhëna janë marrë për bazë dhe janë kontrolluar për efektin e tyre në rezultatet e fituara.

Gjendja shëndetësore e personave me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar kanë të njëjtat nevoja shëndetësore sikurse të gjithë të tjerët, por preken më lehtë nga sëmundjet e ndryshme, p.sh sëmundjet virale, për shkak të sistemit më të dobët imunitar. Për këtë, është e rëndësishme të dijmë rreth gjendjes shëndetësore të personave me nevoja të veçanta në vendin tonë, në mënyrë që të përfshijmë programe intervenuese konkrete.

Në përgjithësi, rezultatet e këtij studimi tregojnë për gjendjen shëndetësore; një shumicë prej 35.7 % e konsiderojnë si të dobët gjendjen e tyre shëndetësore, ndërsa 30.1 % raportojnë për një gjendje shumë të dobët shëndetësore. Një pjesë shumë e vogël e të anketuarve prej 2.1 % raportojnë për një gjendje shumë të mirë shëndetësore. Një prezantim grafik të këtyre të dhënave mund të gjeni në figurën 3.1.




Fig. 3.1. Gjendja shëndetësore e personave me aftësi të kufizuar

Rezultatet e këtij studimi tregojnë që nuk ka dallime të rëndësishme në gjendjen shëndetësore të subjekteve duke u bazuar në gjininë e tyre. Kështu, sikurse meshkujt, ashtu edhe femrat, raportojnë të njëjtin nivel sa i përket gjendjes së tyre shëndetësore $t(143) = .486$ $p = .62$.

Po ashtu, rezultatet e analizës korrelacionale tregojnë që mosha dhe ndjenja e dashurisë të antarëve të familjes ndërlidhen me gjendjen shëndetësore të tyre. Kështu, ekziston një korrelacion signifikant negativ në mes të moshës dhe gjendjes shëndetësore të subjekteve $r(143) = -.177, p=.037$. Kjo tregon se sa më të moshuar që janë, gjendja e tyre shëndetësore është më e dobët. Në anën tjetër, një korrelacion signifikant pozitiv është gjetur në mes të ndjenjës se sa anëtarët e familjes e duan personin dhe gjendjes së tij shëndetësore $r(143)=.179, p = .035$. Pra, sa më e lartë të jetë ndjenja që anëtarët e familjes i duan, aq më e mirë është e gjendja shëndetësore e të anketuarve.

Natyra e nevojave të personave me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar shfaqin vështirësi me natyra të ndryshme dhe me nevoja të cilat manifestohen në shumë mënyra. Këto nevoja janë paraqitur në tabelën 3.1.

Nga natyrat, më i shpeshti tek personat me aftësi të kufizuar është raportuar handikapi fizik më 23.8 %, duke u përcjellë më pas nga problemet mendore (23.1 %). Gjithashtu 8.4 % e respondentëve raportojnë të shfaqin natyrën e tyre të nevojave me sulme epileptike (3.5%).

Një pjesë tjetër e të anketuarve përshkruajnë natyrën e tyre të nevojave, e cila ndërlidhet me vështirësitë që vijnë nga paraliza e këmbës së djathtë (5.6 %).

Handikapi vizual (4.9 %), problemet psikike (4.9%) dhe sindromi down (4.9%) përbëjnë pjesën tjetër të mostrës.

Hemiplegjia apo paraliza e njërës anë të trupit, përfshin rreth 3.5 % e të të anketuarve.

Fig. 3.1.
Natyra e nevojave të këtyre personave

Tabela 3.1. Natyra e nevojave të personave me aftësi të kufizuar		
Natyra e nevojave	Frekuenca	Përqindja
Handikap fizik	34	23.8 %
Probleme mendore	33	23.1 %
Epilepsi	15	8.4 %
Paralizë e këmbës së djathtë	8	5.6 %
Handikap vizual	7	4.9 %
Probleme psikike	7	4.9 %
Sindrom Down	7	4.9 %
Vështirësi në të folur	5	3.5 %
Hemiplegji	5	3.5 %
Pamundësi për të folur	5	3.5 %
Ngecje mendore	3	2.1 %
Ngecje në zhvillim	3	2.1 %

Çrregullimet e të folurit me 7 %, paraqesin vështërsi tek personat me aftësi të kufizuar , duke u shoqëruar edhe me ngecje mendore dhe ngecje në zhvillim.

Në tabelen 7.1 mund të gjeni natyrën e nevojave të personave me aftësi të kufizuar të cilët raportohen në përqindje më të vogël, duke përfshirë gjithsej 10.5 % të mostrës së anketuar.

Tabela 4.0. Natyra e nevojave të personave me aftësi të kufizuar		
Natyra e nevojave	Frekuenca	Përqindja
Hemiparez	2	1.4 %
Protezë dore	4	2.8 %
Handikap auditiv	2	1.4 %
Kardiologjike	2	1.4 %
Hemiparez	2	1.4 %
Kanceri i gjirit	1	0.7 %
Këmba e majtë	1	0.7 %
Paralizë cerebrale	1	0.7 %

Tabela 4.0. Natyra e nevojave të personave me aftësi të kufizuar

Mundësia e qasjes në institucione

Për të identifikuar mundësinë që personat me nevoja të veçanta kanë për t'u qasur në institucione, të anketuarit janë pyetur: “A keni qasje të lira në institucionet tona ”? Shumica prej tyre, rreth 44.8 % raportuan që kanë mundësi qasjeje në institucione. Kurse në anën tjetër, 42.7 % prej tyre, raportuan të mos kenë qasje në institucionet tona; një pjesë e vogël pjesërisht kanë qasje në institucione (1.4 %) mirëpo ka edhe të atillë të cilët asnjëherë nuk kanë qenë në institucione (9.8 %). Fig.4.1.




Fig.4.1. Mundësia e qasjes së lirë në institucione

Përveç mundësisë së qasjes në institucione, një rëndësi të madhe duhet t'i kushtohet edhe përshtatjes së mjedisit. Një mjedis pa barriera, padyshim është një çështje kyç për mundësitë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar në të gjithë sektorët e jetës sociale, duke përfshirë integrimin e tyre në të gjitha fushat e arsimit dhe punësimit.

Kështu të anketuarit u pyetën se sa institucionet tona i përmbushin këto kushte fizike, për t'iu mundësuar një qasje më të lehtë të marrjes së shërbimeve në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët e vendit. Lidhur me këtë, një pjesa më e madhe e të anketuarve, rreth 57.4 %, raportojnë që institucionet në vendin tonë nuk i plotësojnë kushtet fizike.

Në anën tjetër, një pjesë e të anketuarve (31.5 %) kanë qëndrime pozitive lidhur me kushtet fizike nëpër institucionet tona dhe një pjesë e vogël rreth 6.3 %, kanë qëndrime të paanshme sa i përket plotësimit të kushteve fizike në institucionet tona. Për më tepër këto statistika i gjeni të ilustruara edhe në mënyrë grafike në figurën 5.0.




Fig.5.0. Plotësimi i kushteve fizike në intitucione që ofrojnë shërbime për qytetarët

Mbështetja nga ana familjare dhe shoqërore për personat me aftësi të kufizuar

Të gjithë kemi nevojë për mbështetje. Personave me aftësi të kufizuar iu duhet mbështetja familjare dhe shoqërore në fusha të ndryshme, për të përmbushur nevojat e tyre individuale.

Përkrahja nga ana familjare konsiderohet të ketë një rol të madh në përshtatjen e personave me aftësi të kufizuar përbrenda familjes, realizimin e kërkesave personale dhe motivimin e tyre në jetën shoqërore. Përveç kujdesit primar dhe plotësimit të nevojave jetësore, familjarët kujdesen edhe për gjendjen emocionale të të afërmeve.

Kështu, një nga pikat kyç të këtij studimi, është edhe identifikimi i mbështetjes nga ana familjare dhe shoqërore për personat me aftësi të kufizuar.




Fig.5.1. Ndjenja e dashurisë familjare tek personat me aftësi të kufizuar

Rezultatet e këtij studimi tregojnë për mbështetjen dhe dashurinë që i ofron familja personave me aftësi të kufizuar. Nga 143 respondent të përfshirë në mostër, pjesa më e madhe e tyre (51.7 %) kanë dhënë përgjigje pozitive në dashurinë që iu ofron familja, ndërsa 46.2 % plotësisht pajtohen dhe ndjejnë se familja e tyre i do. Në anën tjetër, vetëm 1.4 % e të anketuarve raportojnë përgjigje negative sa i përket ndjenjës së pranimit të dashurisë nga familja e tyre.

Mbështetja e familjes konsiderohet të jetë nevoja më e madhe në lehtësimin e jetesës për personat me aftësi të kufizuar. Kështu, për ta identifikuar këtë, të anketuarit raportuan lidhur me mbështetjen që iu ofron familja e tyre.

Mëse 57.3 % e subjekteve raportuan ta kenë plotësisht përkrahjen e familjes, duke u shoqëruar nga 39.2 % të të anketuarve të cilët pajtohen të kenë përkrahjen e familjes. Në anën tjetër, vetëm një pjesë e vogël nuk pajtohet (1.4 %).




Fig.6.0. Mbështetja nga ana familjare për personat me aftësi të kufizuar

Duke u bazuar në analizën e T- test nuk kemi dallime signifikante në baza gjinore sa i përket mbështetjes nga ana familjare $t(143) = .747$ $p = .456$. Pra, sikurse meshkujt, ashtu edhe femrat, raportojnë të kenë përkrahje të njëjtë nga familja.

Në anën tjetër sipas analizës korrelacionale, kemi një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të dashurisë që ofrohet dhe mbështetjes familjare $r = .708$ $p = .00$. Pra sa më e madhe që të jetë dashuria që familja iu ofron, aq më e madhe do të jetë edhe mbështetja që iu ofrohet personave me aftësi të kufizuar.

Duke vazhduar më tej, mund të shohim se sa subjektet e këtij hulumtimi kanë shokë apo shoqe, me të cilët mund të bisedojnë për problemet e tyre, ku pjesa më e madhe (38.5 %) raportuan ta kenë këtë mundësi. Ndërsa pjesës tjetër (26.6 %) nuk i ofrohet mundësia të bisedojë për problemet me shokë ose shoqe.




Fig.6.1. Ndarja e halleve dhe problemeve me shokë dhe shoqe

Gjithashtu është realizuar edhe analiza korrelacionale e cila tregon për një ndërlidhje signifikante në mes të rrjedhshmërisë në të folur dhe të pasurit shok/shoqe, për të ndarë problemet $r(143) = .371$ $p=0.00$. Pra sa më rrjedhshëm që flasim, aq më shumë do të kenë shokë/shoqe, për t'i ndarë problemet e tyre personat me nevoja të veçanta.

Përveç kësaj, rezultatet e analizës korrelacionale tregojnë për ndërlidhje signifikante në mes të mosrrjedhshmërisë në të folur dhe ndjenjës së paaftësisë për të komunikuar me të tjerët $r(143) = .621$ $p = .00$. Kështu, sa më e madhe të jetë mosrrjedhshmëria në të folur, aq më e madhe do të jetë ndjenja e paaftësisë për të komunikuar drejt me të tjerët.

Po ashtu, ndërlidhje signifikante pozitive është gjetur edhe në mes të ndjenjës së paaftësisë për të komunikuar me të tjerët dhe të pasurit shokë/shoqe, për të ndarë problemet me të tjerët $r(143) = -.386$ $p=.00$. Kjo do të thotë që sa më shumë që personat me aftësi të kufizuar ndihen të paaftë për të komunikuar me të tjerët, aq më pak shokë/shoqe do të kenë për të ndarë problemet e tyre.

Për shumë njerëz me aftësi të kufizuar, ndihma dhe mbështetja janë themelore për përfshirjen në shoqëri. Mungesa e mbështetjes së nevojshme, mund të bëjë që njerëzit me aftësi të kufizuar të jenë të varur nga anëtarët e familjes. Kështu, shumë personave me aftësi të kufizuar iu nevojitet ndihmë dhe mbështetje për kualitet më të mirë jetësor dhe të aftësohen për t'u përfshirë në jetën shoqërore-ekonomike, në mënyrë që të jenë të barabartë me të tjerët.

Kështu, subjektet e anketuara të këtij studimi raportuan se sa ata pranohen nga shoqëria e tyre. Pjesa më e madhe, rreth 40 % prej tyre, pajtohen të kenë përkrahjen e shoqërisë, duke u vazhduar më pas me ata të cilët plotësisht pajtohen (21.7 %) të pranohen nga shoqëria. Kurse 28.7 % e subjekteve në mostër

rapotojnë të mos kenë përkrahjen e shoqërisë së tyre dhe mëse 9.1 % absolutisht nuk pajtohen të pranohen nga shoqëria e tyre.




Fig.7.0. Pranimi nga ana e shoqërisë

Rezultatet e analizës korrelacionale tregojnë për një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të qëndrimeve pozitive që kanë personat me aftësi të kufizuar ndaj vetes dhe asaj se sa ata janë të pranuar në shoqëri $r(143) = .398$ $p = .00$. Pra, sa më shumë që personat me aftësi të kufizuar kanë qëndrim pozitiv ndaj vetes, aq më shumë janë të pranuar në shoqëri.

Përveç kësaj, një ndërlidhje signifikante pozitive është gjetur edhe në mes të pranimi nga ana e shoqërisë dhe vetëvlerësimit që kanë personat me aftësi të kufizuar $r(143) = .335$ $p = .00$. Kësisoj sa më i madh të jetë shkalla e vetëvlerësimit që personat me aftësi të kufizuar kanë, aq më i madh është pranimi nga ana e shoqërisë.

Analiza korrelacionale gjithashtu ka treguar një ndërlidhje signifikante në mes të qëndrimeve pozitive që kanë personat me aftësi të kufizuar ndaj vetes dhe ndjenjës që janë të barabartë me të tjerët $r(143) = .590$ $p = .00$. Kështu, për më tepër, sa më shumë qëndrime pozitive kanë personat me aftësi të kufizuar ndaj vetes, aq më shumë ndihen se janë të barabartë me të tjerët.

Në jetën sociale dhe në shoqërimin me të tjerët shumica prej nesh konsiderohet të kemi një lidhje më të fortë me personat që ne zgjedhim të na përshtaten më shumë në karakteristikat personale dhe interesat e përbashkëta.

Kështu, ne gjithëherë kemi shokë ose shoqe, me të cilët konsiderohet të kemi një lidhje të ngushtë shoqërore. Për këtë arsye, edhe subjekteve të këtij hulumtimi iu kërkua të raportojnë për mbështetjen që shoqëria e ngushtë iu ofron. Së këndejmi, atyre iu shtrua kjo pyetje mohuese: “Unë konsideroj se nuk e kam mbështetjen e shoqërisë sime të ngushtë? Shumica e subjekteve nuk u pajtuan me këtë (37.1 %) dhe 18.9 % absolutisht nuk pajtohen. Ndërsa një përgjigje e kundërt u pranua nga ana e më se 31.5 % e subjekteve; gjithashtu ka edhe prej atyre (11.9 %) të cilët plotësisht pajtohen të mos e kenë mbështetjen e shoqërisë së tyre të ngushtë.




Fig.7.1. Mbështetja nga ana e e shoqërisë së ngushtë

Qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj personave me aftësi të kufizuar

Me rëndësi të madhe në mirëqenien dhe jetën e personave me aftësi të kufizuar janë edhe qëndrimet që kanë qytetarët për ta.

Duke mos i paragjykuar dhe diskriminuar personat me aftësi të kufizuar shoqëria bën që ata të kenë një qasje më të lehtë në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe ato arsimore e kulturore, duke kontribuar kështu në kualitetin e jetesës së tyre.

Subjektet e këtij hulumtimi raportuan për paragjykimet që shoqëria kosovare ka ndaj personave me aftësi të kufizua. Sipas tyre 51.7 % nuk pajtohen që shoqëria në Kosovë nuk i paragjykon personat me aftësi të kufizuar, ndërsa në anën tjetër kur raportojnë për atë se ata personalisht janë paragjykuar për nevojat e tyre të veçanta, shumica prej tyre (49.7 %) kanë një qëndrim negativ. Fig.8.0.




Fig.8.0. Paragjykimet e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuar

“Shoqëria në Kosovë nuk i diskriminon personat me nevoja të veçanta”?, ishte pyetja e cila iu shtrua subjekteve të kësaj mostre. Shumica prej tyre (56.6 %) nuk u pajtuan me këtë dhe vetëm 15.4 % u pajtuan. Në anën tjetër, tek pyetja: “Unë personalisht jam diskriminuar për shkak të nevojave të mia të veçanta”?, ata zgjedhën të mos pajtohen me pohimin (46.2 %) ndërsa vetëm 11.9 % u pajtuan që janë diskriminuar për shkak të nevojave të veçanta.




Fig.8.1. Paragjykimet e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuar

Niveli i arsimimit tek personat me aftësi të kufizuar

Gjithësecili ka të drejtën individuale për edukim dhe shkollim të barabartë, por këtë pikë kyç e këtij hulumtimi është edhe identifikimi i nivelit të arsimimit të personave me aftësi të kufizuar.

Kështu nga gjithsej 143 subjekte të përfshira në mostër, pjesa më e madhe rreth 88.8 % prej tyre nuk janë duke ndjekur shkollimin ose studimet universitare. Dhe vetëm një pjesë e vogël, rreth 9% e të anketuarve, vijojnë mësimin aktualisht në ndonjë shkollë apo universitet.




Fig.8.1. Vijimi në shkollë/ universitet

Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e të anketuarve kanë ofruar përgjigje negative lidhur me vijimin e tyre në ndonjë shkollë apo unversitet, më poshtë mund të shihni arsyet më të shpeshta të cilët subjektet paraqesin.




Fig.9.0. Arsyeja e mosvijimit të shkollës/ universitetit

Gjithashtu, në tabelën në vazhdim janë paraqitur shkollat dhe universitetet ku ndjekin mësimin 9 % e subjektet të kësaj mostre të cilët ofruan përgjigje pozitive në lidhje me vijimin e shkollimit, qoftë atij shkollor apo universitar.

Shkolla/Universiteti	Frekuenca	Përqindja
Universitet AAB	1	0.7
Shkolla e Mesme e Ulët " Imri Halili"	1	0.7
Shkolla e Mesme e Ulët "Liman Rekaj"	1	0.7
Shkolla e Mesme e Ulët " Besim Rexhepi"	2	1.4
Shkolla e Mesme e Ulët " Gjon Serreçi"	1	0.7
Shkolla e Mesme e Ulët" MuharremShemsedini"	2	1.4
Shkolla e Mesme e Ulët " Visar Dodani"	1	0.7
Shkolla e Mesme e Ulët " Pavarsia"	1	0.7
Universitet "Hasan Prishtina"	2	1.4

Fig.9.1. Shkolla/ universiteti ku ndjekin mësimet

Rezultatet e këtij studimi në bazë të analizave inferenciale na tregojnë edhe për ndërlidhjen e ndikimin që kanë variablat me njëra-tjetrën.

Duke u bazuar në rezultatet e analizës korrelacionale, mund të shohim që kemi një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të pranimit nga ana e shoqërisë dhe nivelit të edukimit $r = .237$ $p = .02$. Pra, sa më mirë që pranohen nga shoqëria, personat me aftësi të kufizuar do të kenë një edukim më të mirë.

Shkalla e punësimit tek personat me aftësi të kufizuar

Në të gjithë botën personat me aftësi të kufizuar janë të përfshirë në kryerjen e punëve të ndryshme. Të gjitha detyrat e caktuara në punë mund të realizohen nga personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu duke iu mundësuar qasjen e duhur, shumica e personave me aftësi të kufizuar mund të jenë produktiv.

Kështu, gjithmonë duke pasur parasysh këtë, subjektet u pyetën:“A keni aplikuar ndonjëherë për punë”? Pjesa më e madhe e tyre, rreth 68.5 %, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Pjesa tjetër rreth 25.2 % kanë aplikuar, duke pranuar një përgjigje negative në shumicën e rasteve (18.9 %).




Fig.10.0. Aplikimi në punë

Përgjigje negative që të anketuarit kanë pranuar për arsye të ndryshme janë të paraqitura në tabelen 10.1. Kështu pjesa më e madhe e tyre kanë marrë përgjigje negative, ku sipas të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë arsye të caktuar (7 %). Një ndër arsyet më të shpeshta, e cila ju është ofruar aplikuesve për punë nga ana e punëdhënësve, është mospërbushja e kriterëve për punë (2.8 %), më pas kualifikimet joadekuat (2.1 %) , po ashtu ka pasur raste kur kanë zgjedhur dikë tjetër në vend të tyre (0.7 %).


Nëse përgjigja ka qenë negative, tregoni arsyen që ju është komunikuar.

Përgjigja që është pranuar	Frekuenca	Përqindja
Është plotësuar numri	1	0.7 %
Kanë zgjedhur dikë tjetër	1	0.7 %
Kualifikim joadekuat	3	2.1 %
Nuk janë përmbushur kriteret	4	2.8 %
Mosshkollim i duhur	2	1.4 %
Pa arsyetim	10	7 %

Fig.11.0. Arsyetimet për mospranimin në punë

Se a planifikojnë subjektet e këtij hulumtimi të aplikojnë prapë për ndonjë vend pune, vetëm ¼ e mostrës, apo 25% prej tyre raportuan se kanë në plan ta bëjnë një gjë të tillë.

A planifikoni të aplikoni prapë për ndonjë vend pune?



Ndërsa, shumica e mostrës mëse 75% nuk do të aplikojnë prapë në një vend pune të lirë. Megjithatë për dallim nga pyetja paraprake, vërehet një numër më i madh i subjekteve të cilët planifikojnë të aplikojnë për punë në krahasim me atë se sa kanë aplikuar më parë.

Fig.11.1. Planifikimi të riaplikojnë në punë

Nga 75% e mostrës të cilët nuk planifikojnë të aplikojnë për ndonjë vend pune, kanë paraqitur arsyet e tyre, të cilat mund të shihni në fig. 12.0.

Nëse jo tregoni arsyet pse nuk do të aplikoni sërish?




Fig.12.0. Arsyet e mosaplikimit për punë

Gjithashtu subjektet të cilët punojnë aktualisht raportuan që ndihen të kënaqur me punën e tyre. Edhe pse vetëm një numër i vogël i të anketuarve punojnë, ata të cilët gëzojnë këtë të drejtë ndihen mirë dhe të dobishëm e njëkohësisht të respektuar në vendin e tyre të punës.

Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar

Për të raportuar për gjendjen emocionale, respondentët i janë përgjigjur disa pyetjeve të cilat na lejojnë të kuptojmë më shumë rreth tyre.




Fig.12.1. Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar

Pikëllimi, dekurajimi për të ardhmen dhe shqetësimi përbëjnë tri shtyllat e paraqitura në fig. 13. Përqindja më e madhe e subjekteve kanë deklaruar të jenë të pikëlluar (46.2% pajtohen dhe 30.1% plotësisht pajtohen), në anën tjetër vetëm 16.1% nuk ndihen të pikëlluar duke mos u pajtuar me pohimin dhe vetëm 7% absolutisht nuk pajtohen që ndihen të pikëlluar.

Në shtyllën e dytë mund të shohim përqindjet e raportuara nga ana e subjekteve lidhur me dekurajimin e tyre për të ardhmen. Pjesa më e madhe, 56.6%, janë të dekurajuar për të ardhmen e tyre të përndjekur nga ata të cilët plotësisht pajtohen me një gjë të tillë (18.9%); në anën e kundërt një përqindje e ngjajshme me ata të cilët nuk ndihen të pikëlluar, kështu nuk ndihen as të dekurajuar për të ardhmen (16.8%) dhe 7% absolutisht nuk e shohin vetën të dekurajuar për të ardhmen e tyre. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 71.4%, raportojnë se ndihen të shqetësuar kohëve të fundit (42.7% pajtohen dhe

28.7% plotësisht pajtohen); 16.8 % e subjekteve nuk pajtohen të jenë shqetësuar, ndërsa vetëm 4.9 % absolutisht nuk pajtohen se janë ndjerë të shetësuar kohëve të fundit.




Fig.13.0. Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar

Subjektet e këtij hulumtimi treguan nëse ndihen të dobishëm. Kështu, shumica prej tyre 44.1 % dhe 16.1 % pajtohen që ndihen të dobishëm, ndërsa pjesa tjetër (29.4 %) nuk pajtohen që ndihen të dobishëm duke u pasuar nga 9.8 % e mostrës, të cilët nuk e shohin veten të dobishëm. Sa kanë subjektet e këtij studimi vetëbesim, pjesa me e madhe 49.7% raportojnë të kenë vetëbesim dhe 14.7% të cilët plotësisht pajtohen, në anën tjetër 28% nuk pajtohen dhe vetëm 6.3% absolutisht nuk pajtohen të kenë vetëbesim. Sa i përket interesimit për gjërat e reja 40.6 % pajtohen të kenë interesimin për to, të shoqëruar nga 18.2% të cilët plotësisht pajtohen. Në anën e kundërt 37.1% (nuk pajtohen) dhe 3.5% e mostrës absolutisht nuk pajtohen të jenë të interesur në gjëra të reja




Fig.13.1. Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar

“Unë ndiej që jam një person me vlera, në të njejtën masë me personat e tjerë”. Me këtë u pajtuan pjesa më e madhe e të anketuarve (48.3 %), ndërsa pjesa tjetër 23.2 % nuk pajtohen. Gjithashtu 17.5% e subjekteve plotësisht pajtohen dhe vetëm 9.8 % absolutisht nuk pajtohen.

“Unë ndiej që kam cilësi të mira”. Për këtë pjesa më e madhe 47.6% pajtohen dhe rreth ¼ nuk pajtohen me këtë. Në mostër mund të përshkruhen rreth 15.4 % e subjekteve të cilët plotësisht pajtohen që kanë cilësi të mira dhe vetëm 11.2 % nuk ndjejnë të kenë cilësi të mira. Në mesin e subjekteve të këtij hulumtimi shumica 52.4 % pajtohen që pjesën më të madhe të kohës janë të kënaqur me veten e tyre (10.5 % plotësisht pajtohen) dhe pjesa tjetër, diku rreth ¼ e mostrës, pjesën më të madhe të kohës nuk janë të kënaqur me veten e tyre dhe vetëm 8.4 % absolutisht nuk janë të kënaqur.

Nëse shohim rezultatet e analizës korrelacionale, ato na tregojnë për një korrelacion në mes të cilësive të mira dhe qëndrimeve pozitive që kanë personat me aftësi të kufizuar $r(143) = .732 p = .00$. Në anën tjetër ndjenja e cilësive të mira nuk ndërlidhet me diskriminimin e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuar $r(143) = -.023 p = .705$. Pra ndjenja e personave me aftësi të kufizuar për cilësitë e mira të tyre nuk ndërlidhet me diskriminimin e shoqërisë ndaj këtyre personave.




Fig.14.0. Gjendja emocionale e personave me aftësi të kufizuar

Vetëknaqësia, vetërespekti dhe ndjenja e të qenurit i dobishëm, luajnë një rol të madh në funksionimin tonë të përditshëm si dhe në kualitetin e jetës. Për këtë arsye shumica e subjekteve të kësaj mostre raportuan që pjesën më të madhe të kohës janë të kënaqur me veten e tyre (52.4%) duke vazhduar me 10.5 % të cilët plotësisht pajtohen, ndërsa në të kundërtën 27.3 % e subjekteve nuk pajtohen të jenë të kënaqur me veten e tyre, duke vazhduar me 8.4 % të cilët absolutisht nuk janë të kënaqur.

Më shumë se gjysma e subjekteve të këtij studimi (65 %) do të kishin dëshirë të kenë më shumë respekt për veten e tyre dhe 10.5 % të cilët pajtohen plotësisht që do të dëshironin të kenë më shumë respekt për veten e tyre; në anën tjetër rreth 23.8 % konsiderojnë të kenë respekt të mjaftueshëm për veten e tyre.

Të anketuarit kanë raportuar edhe për ndjenjën e të qenurit i padobishëm, e më këtë janë pajtuar 52.4 %, duke vazhduar me 28 % të cilët pajtohen plotësisht. Në anën tjetër, një pjesë e vogël e mostrës nuk pajtohen të ndihen të padobishëm 14 % dhe 4.9 % të cilët absolutisht nuk pajtohen.




Fig.14.1. Komunikimi në mes të personave me aftësi të kufizuar dhe njerëzve që i rrethojnë

Një pjesë e madhe e zhvillimit të jetës sociale bëhet e mundur përmes komunikimit më të tjerët. Kështu, të anketuarit raportuan edhe për nivelin dhe mënyrën e komunikimit që ata realizojnë me të tjerët. "Unë flas shumë pak me të tjerët", ishte pohimi që të anketuarit pranuan për t'u përgjigjur. Me këtë rast shumica prej tyre (35.7 %) u pajtuan ndërsa 31.5 % nuk u pajtuan. Në anën tjetër, 19.5% pajtohen plotësisht që flasin shumë pak me të tjerët dhe 15.4 % absolutisht nuk pajtohen.

"Ndihem në siklet kur më duhet të flas me të tjerët". 31.5% e mostrës nuk pajtohen ndërsa 27.3% pajtohen se ndihen në siklet kur flasin me të tjerët duke u ndjekur me 21.7 % të cilët pajtohen plotësisht dhe vetëm 18.8 % e mostrës absolutisht nuk pajtohen të ndihen në siklet kur flasin me të tjerët.

"Të rrallë janë ata që duan të flasin me mua". Pjesa më e madhe e mostrës 36.4 % nuk pajtohen, ndërsa pjesa tjetër 29.4 % pajtohen. 21% e subjekteve absolutisht nuk pajtohen se janë të rrallë ata që flasin me ta, duke u ndjekur 11.9 % të cilët plotësisht pajtohen më një gjë të tillë.




Fig.13.1. Të folurit e rrjedhshëm tek personat me aftësi të kufizuar

Të flasësh rrjedhshëm është baza e një komunikim të mirëfilltë me të tjerët. Kështu më shumë se gjysma e të anketuarve 59.5 % raportojnë që flasin rrjedhshëm. Ndërsa 39.9 % pajtohen që nuk flasin rrjedhshëm (grafikoni.1.2).

Duke u bazuar në rezultatet e analizës korrelacionale, mund të shohim që kemi një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të mosrrjedhshmërisë në të folur dhe moskomunikimit me të tjerët $r(143) .339 p= .00$. Kjo do të thotë, sa më e madhe të jetë mosrrjedhshmëria në të folur, aq më i madh do të jetë edhe niveli i moskomunikimit me të tjerët.




Fig.13.1. Aftësia për të komunikuar me të tjerët

"Ndjej se nuk jam e aftë të flas dhe të komunikoj me të tjerët". Më shumë se gjysma e respondentëve nuk pajtohen me një gjë të tillë (58.8 %) dhe 40.6 % pajtohen që nuk ndihen të aftë të flasin dhe të komunikojnë me të tjerët.

Gjthashtu analiza korrelacionale tregon ndërlidhje signifikante pozitive në mes të paaftësisë për të komunikuar me të tjerët dhe moskomunikimit ($r(143) = .465$ $p = .00$). Pra, sa më e madhe të jetë paaftësia për të komunikuar, aq më i vogël do të jetë edhe niveli i komunikimit me të tjerët. Po ashtu edhe mosrjedhshmëria në të folur ndërlidhet me ndjenjën e paaftësisë për të komunikuar me të tjerët ($r(143) = .621$ $p = .00$).

Përfundime me bllok fakte

Shumica e pjesëmarrësve në këtë hulumtim (66 %) e konsiderojnë gjendjen e tyre shëndetësore si të dobët apo shumë të dobët. Shumica e pjesëmarrësve të përfshirë në këtë hulumtim, kanë handicap fizik (23.8 %) apo probleme mendore (23.1 %). Një pjesë e madhe e tyre (42.7 %) e konsiderojnë se nuk kanë qasje të lirë në institucionet tona dhe shumica (57.4 %) konsiderojnë se institucionet tona nuk i plotësojnë kushtet fizike për të pasur qasje në to. Vetëm 1 % e pjesëmarrësve raportojnë se nuk kanë mbështetjen e duhur nga ana e familjes. Por, shumë më e madhe është mungesa e përkrahjes së shoqërisë. Rreth 40 % e pjesëmarrësve deklarojnë që nuk kanë shokë apo shoqe me të cilët mund të bisedojnë hallet apo problemet e tyre. Për më tepër, rreth 1/3 e subjekteve të këtij hulumtimi deklarojnë që shoqëria nuk i pranon ashtu siç janë. Ndërkaq, 1 në 4 persona me aftësi të kufizuar, beson që shoqëria në Kosovë i paragjykon fëmijët me aftësi të kufizuar dhe gjithashtu 1 në 5 persona kanë qenë të paragjykuar për nevojën e tyre të veçantë. I njëjtë është edhe proporcioni i subjekteve që gjykojnë se kanë qenë të diskriminuar apo që shoqëria kosovare në përgjithësi është shoqëri që diskriminon personat me nevoja të veçanta. Në anën tjetër, shumica e personave me aftësi të kufizuar, nuk kanë mundësi që të vazhdojnë shkollimin dhe kjo kryesisht për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore apo edhe aftësisë së kufizuar. Pos shkollës, shumica e pjesëmarrësve janë pyetur edhe për mundësitë e punësimit. 68.5 % nuk e kanë aplikuar asnjëherë për një vend pune, duke menduar që nuk i plotësojnë kushtet apo edhe nuk i kanë kualifikimet e duhura. Në anën tjetër, është shqetësuese gjendja emocionale e subjekteve të intervistuar. Kjo për shkakun e thjeshtë që shumica e tyre (rreth 80 %) përjetojnë aktualisht ndjenjën e pikëllimit, dekurajimit për të ardhmen dhe shqetësimit. Një problem tjetër mbetet edhe çështja e komunikimit me të tjerët, përderisa shumica e respondentëve e konsiderojnë që nuk janë të aftë të komunikojnë si duhet apo edhe kanë probleme të ndryshme në qasje.

Rekomandimet

Duke u bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, rekomandohet:

- Inicimi i programeve të reja intervenuese dhe fuqizimi i programeve ekzistuese që mundësojnë përfshirjen dhe integrimin sa më të mirë të personave me aftësi të kufiuar në shoqëri;
- Ofrimi i kampanjave vetëdijesuese dhe trajnimeve për familjet e personave me nevoja të veçanta, që mundësojnë identifikimin e qasjeve të suksesshme që rezultojnë në përmirësim të gjendjes shëndetësore dhe pozitës sociale të personave me aftësi të kufizuar;
- Kampanja të avokimit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në arsimin e formal dhe jo formal në Kosovë;
- Punësimin e stafit profesional për personat me aftësi të kufizuar nëpër shkolla;
- Kampanja të avokimit për ofrimin e mundësive të barabarta për punësim edhe për personat me aftësi të kufizuar;
- Projekte intervenuese për përmirësimin e kualitetit jetësor dhe përfshirjen e tyre të barabartë në jetën sociale;
- Kampanja të vetëdijësimit për eliminimin e paragjyqimeve dhe diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.